

**VENDIM I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE
“ABA HOLDING” SHPK**

Rendi i dites: Shoqeria “ABA TELECOMMUNICATIONS & TECHNOLOGY” Sh.p.k.

Sot, ne date 14.11.2023, ne seline e Shoqerise “ABA HOLDING” Sh.p.k. person juridik shqiptar, e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me date 29/05/2023, me NUIS Nr. M31729016I, mbahet kjo Mbledhje e Ortakeve te Shoqerise:

Z. Ahmet Ulaj, zoterues i **33%** (tridhjetë e tre përqind) te Kapitalit te Shoqerise, shtetas shqiptar, i biri i Isës dhe Zades, i datëlindjes 01.08.1951, i lindur ne Vuthaj, banues në Tiranë, ne adresën: Rruga “ Ismail Qemali”, identifikuar me Karten e Identitetit me Nr. personal F10801085Q ;

Z. Astrit Ulaj, zoterues i **33%** (tridhjetë e tre përqind) te Kapitalit te Shoqerise, shtetas shqiptar, i biri I Ises dhe Zades, i datelindjes 1967, banues ne Rrugen “Ismail Qemali”, identifikuar me Karten e Identitetit me Nr. personal G70415293P;

Z. Bashkim Ulaj, zoterues i **34%** (tridhjetë e kater përqind) te Kapitalit te Shoqerise, shtetas shqiptar, i biri i Ises dhe Zades, lindur me 15.03.1963, banues ne Tirane ne adresën Rr.”Mustafa Matohiti”, identifikuar me Karte Identiteti me Nr. G30315336U.

Perfaqesues te 100% te kapitalit te Shoqerise “ABA HOLDING” Shpk me qender ne me seli ne Rruga “Papa Gjon Pali i II-te”, Ndërtesa nr. 12, ABA Business Center, Njesia Administrative nr.2, Tirane, Shqiperi, Nr. Pasurie 7/52-N9 , Zona Kadastrale 8160, themeluar dhe regjistruar si person juridik shqiptar ne Qendren Kombetare te Biznesit, date 29.05.2023, me NUIS M31729016I.

Te cilet ne perputhje me procedurat e parashikuara ne Ligjin 9901, dt.14.04.2008 “Per Shoqerite Tregtare” si dhe Dispozitave 64-78 te K.C mbi perfaqesimin:

VENDOSEN:

1. Shoqëria “**ABA HOLDING**” **Sh.p.k.** të marrë pjesë në krijimin e Shoqërisë së re me përgjegjësi të kufizuar, me emërtëse “**ABA TELECOMMUNICATIONS & TECHNOLOGY**” **sh.p.k.**
2. Shoqëria e Re “**ABA TELECOMMUNICATIONS & TECHNOLOGY**” **sh.p.k.**, do të kryejë në territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj aktivitetin e mëposhtëm në fushën e teknologjive dhe të telekomunikacionit:

Shoqëria e Re “**ABA TELECOMMUNICATIONS & TECHNOLOGY**” **sh.p.k.**, do të kryejë në territorin e Republikës së Shqipërisë apo jashtë saj aktivitetin e mëposhtëm në fushën e teknologjive dhe të telekomunikacionit:

(i) **Aktivitete në lidhje me:**

- Ndertimin, zhvillimin dhe operimin e qendrave të dhenave elektronike (DataCenter), e shërbimeve për pajisjet e telekomunikacionit të paleve të treta dhe sigurimi i mbështetjes teknike dhe shërbimeve operacionale përkatëse. Instalimi, blerja dhe shfrytëzimi i infrastrukurës dhe pajisjeve përkatëse. Sigurimi i shërbimit të konsulencës për operatorët e tjerë të telekomunikacionit.

- Ndertimin, zhvillimin dhe funksionimin e infrastrukurës telekomunikative. Pronësinë dhe shfrytëzimin e infrastrukurës së telekomunikacionit dhe të stacioneve tokësore të infrastrukurës së cituar Import-ekportin e pajisjeve të telekomunikacionit. Zhvillimin e shërbimeve të tjera të Telekomunikacionit si: Shërbimet për sistemin e fibrave optike, Dhenie me qira e fibrave të zinj, Shërbimet për sistemin wired (duke përfshirë sistemin optik), Ndertimin e linjave me qira, Dhenie me qira e pjesës së kapacitetit, Ndertimin e Sistemit Virtual Privat (VPN), Transmetimin e të Dhenave Transmetimin e të Dhenave me vlerë të shtuar, Telemetrisë - telematik- ndertimin e shërbimeve për vendndodhjen e radios Tekst Audio. Ndertimin e shërbimit të Aksesit të Internetit, Shërbimin ndihmes për transmetim (audio, transmetimin e sinjaleve të videos ndërmjet kompanive të ndryshme të transmetimit). Shërbimet për shërbime të sinjaleve të përdorueshme për Transmetim Shpërndarjen e sinjaleve të transmetimit, Shërbimi i telefonisë i disponueshëm botërisht, Shërbimet e Zërit për Shërbimet e Protokollit të Internetit (VoIP), Shërbimet e telefonisë të disponueshme botërisht në vendndodhje të fiksuara nëpërmjet kartave me parapagesë.

- Shërbime në fushën e komunikimeve elektronike si: Operator i rrjetit dhe shërbimeve për transmetim të dhenash/internet. Operator i rrjetit dhe shërbimeve për telefoni publikë të qendruarshme (telefoni fikse). Shërbime të transmetimit të të dhenave. Shërbime të linjave me qira. Shërbime të transmetimit të të dhenave (data). IP TV. Përfaqësimin e shoqërive të huaja në çdo territor sipas autorizimeve përkatëse të paisura prej tyre. Përfshirja dhe

ofrimi i perzgjedhjeve per tendera apo kompani me natyre telekomunikacioni. Shkollime per te interesuarit me ose pa eksperience ne fushen e teknologjise se avancuar. Aktivitete import-eksporti te makinerive e paisjeve te fushes se telekomunikacionit. Import-eksport per mallra te ndryshme per nevoja te ushtrimit te aktivitetit te shoqerise. Regjistrimin e domaineve.al dhe nëndomaineve ose emërtim që perfshin regjistrimin e domaineve. Sherbim publik telefonik te lëvizshëm (mobile) komunikim zanor, sms, data, shërbime me vlerë te shtuar, etj., permes kartave me parapagim dhe paspagim.

- (ii) Themelimi dhe krijimi i shoqërive dhe sipërmarrjeve shqiptare dhe të huaja, si dhe pjesëmarrja në to, administrimi dhe drejtimi i shoqërive tregtare dhe sipërmarrjeve vendase apo të huaja perfshirë shoqëri koncesionare, apo partneritete publike private, te cilat ushtrojne aktivitete ne fushen e telekomunikacionit dhe teknologjisë;
- (iii) Marrja pjesë në shoqëri e bashkime shoqërish të themeluara apo në themelim e sipër, ne cdo forme te parashikuar nga Ligji që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin, apo pjesemarrje te tjera, qe i shërbejnë rritjes së mëtejshme dhe arritjes së qëllimeve të Shoqërisë;
- (iv) Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë (A) çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme apo ato të paluajtshme, si dhe të kryejë çdo aktivitet tregtar, financiar, përfshirë titujt, të vendosë pengje dhe barrë hipotekare mbi kuota/aksione të shoqërive të krijuara ose ku ajo është pjesëmarrëse; aktivitete këto të konsideruara si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë, dhe të shoqërive e sipërmarrjeve të themeluara/krijuara, apo në të cilat Shoqëria fiton pjesëmarrje si dhe (B) çdo veprimtari tjetër të lejuar nga ligji.
- (v) Shoqëria do të kryejë çdo lloj aktiviteti dhe çdo lloj operacioni ekonomik, juridik e financiar si dhe çdo operacion biznesi, që lidhet direkt apo indirekt me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë dhe për të favorizuar atë, Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standardet më të larta të etikës.


3. Kapitali themeltar i Shoqerise se Re **“ABA TELECOMMUNICATIONS & TECHNOLOGY” sh.p.k.** do te jete ne vleren totale 100,000 Leke (njeqind mije Leke), i perbere nga 1 kuote qe perfaqeson 100% te kapitalit te regjistruar te Shoqerise dhe te te drejtave te votes ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve, e cila zoterohet nga Ortaku i vetem i saj, shoqeria **“ABA HOLDING” Sh.p.k.**
4. Administratori i pare i Shoqerise se re **“ABA TELECOMMUNICATIONS & TECHNOLOGY” sh.p.k** do te jete Znj. Artila Ulaj, shtetase Shqiptare, lindur ne Mamurras, Kruje dhe banuese ne Tirane, me adrese Rruga “M. Matohiti”; Nd. 7; H. 1; lindur me 05.09.1981, identifikuar me Leternjoftim ID me nr. personal I15205096A.
5. Kohezgjatja e Shoqerise se re **“ABA TELECOMMUNICATIONS & TECHNOLOGY” sh.p.k** do jete e papercaktuar.
6. Selia e Shoqerise **“ABA TELECOMMUNICATIONS & TECHNOLOGY” sh.p.k** do te percaktohet ne Statutin e Shoqerise se re nga Perfaqesuesi ne ushtrim te tagrave te dhena ne piken e permendur me poshte.


7. Dhenien e tagrave te perfaqesimit te Shoqerise “ABA TELECOMMUNICATIONS & TECHNOLOGY” sh.p.k administratorit te Shoqerise, Z. BASHKIM ULAJ, identifikuar me letërnjoftim me nr. personal G30315336U, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me te drejten e pergatitjes dhe te nenshkrimit te Statutit te Shoqerise se re “ABA TELECOMMUNICATIONS & TECHNOLOGY” sh.p.k Perfaqesuesi do te kete autoritetet te plote per te vendosur per te gjitha ceshtjet qe do te perfshihen ne Statutin e Shoqerise se Re dhe menyren e trajtimit te tyre, si dhe te angazhoje Shoqerine ne lidhje me kushtet dhe termat e Statutit, si dhe te miratoje dhe vendose e te nenshkruaj eaktet perkatese per cdo ndryshim te metejshem te Statutit. Perfaqesuesi do te ushtroje te drejtat qe i jane dhene nepermjet ketij vendimi per nje periudhe kohe te pacaktuar.

Pas perfundimit te temave te rendit te dites Ortaket e Shoqerise shpallen mbylljen e mbledhjes.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË “ABA HOLDING” SH.P.K.

Emrat dhe nënshkrimet e Ortakëve:


Z. Ahmet Ulaj


Z. Astrit Ulaj


Z. Bashkim Ulaj

